



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 10 (827762)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 Mars 2022

Zëvendësministria Bici: Tashmë ju jeni pjesë e FA, me kontratë pune të sigurt dhe përfitues të të drejtave të Statusit të Ushtarakut

Mbi 300 të rinj e të reja fituan të drejtën të bëhen pjesë e personelit të Forcave të Armatosura, në përfundim të fushatës së rekrutimit që u shtri në të gjithë vendin në periudhën tetor 2021 - janar 2022. Kandidatët për ushtarë/detarë aktivë do të kryejnë stërvitjen bazë në Bunavi. Në ceremoninë e përcjelljes së tyre, zëvendësministria e Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici përgëzoi për punën e bërë Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, Qendrën e Personel Rekrutimit...

» faqe 2



Gjeneralmajore Manushaqe Shehu: Nderi, Detyra, Atdheu, "kodi i jetës" së ushtarakut



» faqe 2

Situata në Ukrainë pas pushtimit nga Rusia Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Konflikti duhet kontrolluar dhe mbajtur jashtë kufijve të NATO-s



Mbledhje e jashtëzakonshme e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s për Ukrainën

» faqe 3

Gjeneralmajor Begaj: Mirënjohje Mbretërisë së Bashkuar për kontributin e dhënë ndër vite

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim përshëndetës atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar për Shqipërinë dhe Malin e Zi, nënkolonel Christopher Maycock, në kuadër të përfundimit të mandatit të tij 3-vjeçar në Tiranë. Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke theksuar faktin se gjatë qëndrimit në detyrë të nënkolonel Maycock, plani i bashkëpunimit...



» Faqe 2

Gjeneral brigade Lisa Hou: Bashkëpunimi midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe të SHBA-ve do të vijojë edhe në të ardhmen

Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryesuar nga gjeneral brigade Lisa Hou, komandante e Gardës së New Jersey-it, zhvilluan një vizitë pune në Bazën Ajrore Farkë, ku u prit nga i deleguari i komandantit të Forcës Ajrore kolonel Gjergji Vasili dhe komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata si edhe pilotë, staf e personel i Forcës Ajrore. Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it ishte i përbërë nga kolonel Yvonne Mays, drejtor shtabi në Gardën e New Jersey-it, nënkolonele...



» Faqe 5

AFA, zgjedhja drejt të ardhmes së sigurt
Intervistë me ushtarakët e rinj:
Lorena Demaj, Soni Domi dhe Andrea Dumka

Arsimimi ushtarak shqiptar ka kaluar një rrugë plot sakrificë dhe arritja e përsosmërisë në sistemin arsimor është një proces në zhvillim e sipër. Arsimimi është mjeti i suksesit tonë të ardhshëm, arsimimi i mirë i brezave rrit kohezionin shoqëror, garanton ruajtjen dhe përcimin e vlerave kombëtare, si dhe rrit ndërvlerimin rreth vetes dhe botës. Ai i aftëson ushtarakët për të përmbushur qëllimet më të rëndësishme për vendin...



» Faqe 6-7

Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj: Mirënjohje Mbretërisë së Bashkuar për kontributin e dhënë ndër vite në trajnimin, arsimimin dhe stërvitjen e personelit të FARSH

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj priti në një takim përshëndetës atashëun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar për Shqipërinë dhe Malin e Zi, nënkolonel Christopher Maycock, në kuadër të përfundimit të mandatit të tij 3-vjeçar në Tiranë.

Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke theksuar faktin se gjatë qëndrimit në detyrë të nënkolonel Maycock, plani i bashkëpunimit midis dy vendeve ka pësuar një rritje të qëndrueshme në numrin e aktiviteteve të zhvilluara, pavarësisht masave kufizuese nga



pandemia e Covid-19.

“Si vend anëtar i NATO-s që ndajmë të njëjtat vlera euroatlantike, ne i jemi mirënjohës Mbretërisë së Bashkuar për kontributin e dhënë

ndër vite në trajnimin, arsimimin dhe stërvitjen e personelit të FARSH, ku do të veçoja stërvitjet periodike midis Forcave Speciale dhe trajnimit në fushën e leadershipit. Roli



i Zyrës së Atashëut Ushtarak, në realizimin me sukses të këtyre aktiviteteve, në vlerësimin tim ka qenë dhe mbetet kritik”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor

Begaj. Nga ana e tij, nënkolonel Maycock e falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH për mbështetjen e treguar nga FARSH gjatë kohës së qëndrimit të tij në detyrë, si dhe e siguroi atë se edhe pasardhësi i tij do të vijojë me të njëjtin intensitet punën për vijimin dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve. Në përfundim të takimit, gjeneralmajor Begaj, duke i uruar suksese të mëtejshme, i akordoi nënkolonelit Maycock një “Certifikatë Mirënjohje”, me motivacion: “Për kontributin e vyer në forcimin e marrëdhënieve ushtarake në fushën e trajnimit, stërvitjes dhe modernizimit”.

Zëvendësministria Bici: Tashmë ju jeni pjesë e Forcave të Armatosura, me kontratë pune të sigurt dhe përfitues të të drejtave të Statusit të Ushtarakut të Republikës së Shqipërisë

Gjeneralmajore Manushaqe Shehu: Nderi, Detyra, Atdheu, “kodi i jetës” së ushtarakut

Mbi 300 të rinj e të reja fituan të drejtën të bëhen pjesë e personelit të Forcave të Armatosura, në përfundim të fushatës së rekrutimit që u shtri në të gjithë vendin në periudhën tetor 2021 - janar 2022.

Kandidatët për ushtarë/detarë aktivë do të kryejnë stërvitjen bazë në Bunavi. Në ceremoninë e përcjelljes së tyre, zëvendësministria e Mbrojtjes, Dallëndyshe Bici përgëzoi për punën e bërë Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, Qendrën e Personel Rekrutimit, si dhe të gjithë personelin e angazhuar në kushtet e vështira të pandemisë së Covid - 19.

Duke iu drejtuar të rinjve, zëvendësministria Bici u shpreh: “Nga dita e sotme ju jeni pjesë e Forcave të Armatosura. Do të keni kontratë pune të rregullt dhe të sigurt, shërbim shëndetësor falas për vete e familjen mundësi arsimimi dhe kualifikimi brenda e jashtë vendit pa pagesë, aftësim profesional, si dhe përfitoni të gjitha të drejtat që parashikon Statusi i Ushtarakut të Republikës së Shqipërisë”.

Gjatë fushatës së rekrutimeve u regjistruan, sipas kriteve, 409 kandidatë, 46 prej tyre femra. Por vetëm 305 prej kandidatëve fituan të drejtën për t’u bërë pjesë e personelit të FA-së.

Ndërsa në emër të shtabit të përgjithshëm përshëndeti gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila u uroi mirëseardhjen rekrutëve të rinj dhe familjarëve të tyre, një pjesë e të cilëve ishin të pranishëm në ceremoni, si dhe i falënderoi për përkrahjen që iu kanë dhënë fëmijëve të tyre, në iniciativën për t’u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

“Ne, pjesëtarët e Forcave të Armatosura, -vazhdoi më tej gjeneralmajore Shehu, -kemi një kod me tre fjalë, në dukje të thjeshta, por të



arta: “Nderi, detyra, atdheu”.

Gjatë këtij kursi ju do ta mësoni kuptimin e këtyre fjalëve

të gërshetuara me ndjenjën e sakrificës dhe përgjegjshmërisë. Shpresoj dhe pres shumë nga ju!”

Zëvendësministria Bici: Tashmë ju jeni pjesë e Forcave të Armatosura, me kontratë pune të sigurt, shërbim shëndetësor falas për vete e familjen, si dhe përfitoni të gjitha të drejtat që parashikon Statusi i Ushtarakut të Republikës së Shqipërisë.





Mbledhje e jashtëzakonshme e ministrave të Mbrojtjes të NATO-s për Ukrainën, Peleshi: Shqipëria e gatshme për ndihmë humanitare, vëmendje ndaj Ballkanit

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Konflikti duhet kontrolluar dhe mbajtur jashtë kufijve të NATO-s, pasi ndikimi rus në Ballkan konsiderohet rrezik real për rajonin

Në selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë, u zhvillua takimi i jashtëzakonshëm i ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, ku fokusi kryesor ishte situata në Ukrainë pas pushtimit nga Rusia.

Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi, në fjalën e tij, qartësoi edhe njëherë pozicionin e Shqipërisë në mbështetje të plotë të integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës si dhe dënoi rëndë shkeljen e ligjit ndërkombëtar nga ana e Rusisë. Ai solli në vëmendje se, Shqipëria iu bashkua pa asnjë hezitim vendeve të tjera të NATO-s dhe BE-së, që vendosën sanksione ndaj Rusisë, si dhe gatishmërinë e plotë të qeverisë shqiptare për të ofruar ndihmë dhe asistencë humanitare për Ukrainën.

Në kuadër të rritjes së vigjilencës dhe masave për përforsimin e krahut lindor dhe juglindor të Aleancës, zoti Peleshi shtoi se, vendi ynë ka deklaruar se është i gatshëm të zbatojë detyrimet e veta si një aleat me vlerë dhe i besueshëm krah për krah



aleatëve të tjerë.

Në përfundim, ministri Peleshi kërkoi nga Aleanca vëmendje të shtuar dhe analizë të kujdesshme për rajonin e Ballkanit, ndonëse fokusi mbetet situata në Ukrainë. Ai tha se konflikti duhet kontrol-

luar dhe mbajtur jashtë kufijve të NATO-s, pasi ndikimi rus në Ballkan konsiderohet rrezik real për rajonin.

Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, zoti Jens Stoltenberg dënoi agresionin rus ndaj Ukrainës dhe rikonfirmoi

mbështetjen e plotë politike dhe asistencën e vazhdueshme ushtarake nga NATO për Ukrainën. Gjithashtu, ai theksoi nevojën për përforsimin e Deterrencës (Parandalimit) dhe Mbrojtjes së Aleancës, veçanërisht në Lindje dhe Jug-

“Shqipëria iu bashkua pa asnjë hezitim vendeve të tjera të NATO-s dhe BE-së, që vendosën sanksione ndaj Rusisë, si dhe gatishmërinë e plotë të qeverisë shqiptare për të ofruar ndihmë dhe asistencë humanitare për Ukrainën”.

lindje të kufijve të saj, ku për herë të parë që nga krijimi i saj, NATO po dislokon Forcat e Reagimit në këto vende. Ky ministerial i paraprin Samitit të Jashtëzakonshëm të NATO-s, i cili do të zhvillohet në Bruksel, më datë 24 mars.

CEREMONIA

Ndërtohet ura e re tip "Bailey" në njësinë administrative Nikël të bashkisë Krujë

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios, të Komandës Mbështetëse, kanë realizuar me sukses ndërtimin e urës tip "Bailey", me gjatësi 24 m, seksion 1/2 dhe me peshëmbajtje deri në 40 ton, në njësinë administrative Nikël të bashkisë Krujë, e cila ishte prishur për shkak të amortizimit.

Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Hajdar Gurra si dhe deputeti i zonës z. Rrahman Rrahja, nënkryetari i bashkisë Krujë z. Ilir Loci dhe administratori njësisë administrative Nikël, z. Besnik Deliu.

Në fjalën e tij përshëndetëse shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj përgëzoi Kompaninë e Urave për punën e tyre të palodhur dhe premtoi se do të kenë gjithmonë vëmendjen dhe mbështetjen e duhur në kontributin e tyre të vyer ndaj komunitetit në nevojë.

Gjithashtu komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, në ceremoninë e inaugurimit të kësaj vepre, u shpreh se lidhja e këtyre zonave rurale nëpërmjet urave "Bailey" janë një tregues i qartë i mbështetjes së Forcave të Ar-



matosura për popullsinë në çdo situatë nevojë, mbështetje e cila do të vijojë në çdo rast që të jetë e nevojshme. Nga ana e përfaqësuesve të pushtetit lokal, fjalën e mori deputeti i zonës, i cili, ndër të tjera, theksoi korrektesën dhe punën intensive e të shkëlqyer të xhenierëve gjatë periudhës së punimeve për ndërtimin e urës "Bailey", në Nikël të bashkisë Krujë. Ndërtimi i kësaj ure, është i një rëndësie të veçantë nga pikë-

pamja sociale dhe ekonomike, në shërbim të një komuniteti prej rreth 1700 banorësh. Kjo urë bën të mundur lidhjen e fshatrave: Vrijon i Poshtëm, Vrijon i Sipërm, Greps, Buro. Gjithashtu bën të mundur lidhjen e shkollave 9-vjeçare si dhe qendrave shëndetësore, duke iu mundësuar lehtësi në përfitim të shërbimit shëndetësor sa më të shpejtë e në lëvizje, popullsisë së kësaj zone.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj përgëzoi Kompaninë e Urave për punën e tyre të palodhur dhe premtoi se do të kenë gjithmonë vëmendjen dhe mbështetjen e duhur në kontributin e tyre të vyer ndaj komunitetit në nevojë.

Aktivizohet zyrtarisht Grup Batalioni i Këmbëtorisë së Lehtë

Grup Batalioni i Këmbëtorisë së Lehtë i Forcës Tokësore (GB-KLFT), zhvilloi në ambientet e garnizonit të Zall-Herrit, një rreshtim organik me të gjithë elementët e tij përbërës.

Trupat e GBKL, u përshëndetën nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili e vlerësoi këtë moment si tepër të rëndësishëm, jo vetëm për Forcën Tokësore, por për të gjithë Forcat e Armatosura.

"Sot, ne fillojmë një proces tepër të rëndësishëm, atë të përgatitjes, stërvitjes dhe vlerësimit të GBKL si një strukturë e organizuar për detyrë, që formohet nga bashkimi i kapaciteteve të luftimit, të mbështetjes me luftim, si dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit, të cilat gjenerohen nga strukturat e FT-së dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ka ardhur momenti, që procesit të trajnimit individual dhe kolektiv, t'i japim një tjetër dimension, i cili do të përfundojë me zhvillimin e stërvitjes "Biza-22", stërvitje kjo e cila do të monitorohet nga një ekip i NATO-s", - tha ndër të tjera në fjalën e tij, komandanti i Forcës Tokësore.

Më tej, ai kërkoi angazhim maksimal nga të gjithë efektivet e GBKL, duke demonstruar aftësi, njohuri dhe kompetencë gjatë gjithë procesit të stërvitjes dhe vlerësimit, duke i siguruar ata jo vetëm për mbështetjen e tij personale, por edhe atë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të



Armatosura dhe ministrit të Mbrojtjes.

Ndërkohë, nga ana e tij komandanti i batalionit të Dytë të Këmbëtorisë (b2k) dhe njëkohësisht edhe komandant i Grup Batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë, nënkolonel Agim Kuçana, në fjalën drejtuar trupave të GBKL, u shpreh i bindur se çdo element përbërës i këtij Grup Batalioni ka për të përmbushur më së miri detyrimet që dalin para tyre, për të arritur me sukses cer-

tifikimin në muajin shtator. Aktiviteti, u mbyll me inspektimin e trupave, pajisjeve dhe mjeteve, të Grup Batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë.

Gjeneral brigade Xhebexhia: Donacionet e Turqisë për FA kanë dhënë një ndihmesë të madhe në përballimin e operacioneve, në mbështetje të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie atashen ushtarak të Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay. Gjeneral brigade Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen kolonelit turk, e falënderoi atë për mbështetjen që Turqia i ka dhënë Forcave tona të Armatosura dhe Komandës Mbështetëse ndër vite dhe në mënyrë të veçantë për ndihmën e madhe në kuadër të emergjencave civile (EC). "Donacionet e Turqisë për Forcat e Armatosura në përgjithësi dhe për Komandën Mbështetëse në veçanti kanë dhënë një ndihmesë të madhe në kryerjen e detyrave dhe përballimin e operacioneve në mbështetje të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore", - u shpreh gjeneral brigade Xhebexhia.

Ndër të tjera gjeneral brigade Xhebexhia bëri me dije kolonelin Kablay mbi ristrukturimin e ri të njësive të Emergjencave Civile si dhe shtoi se sapo këto struktura të marrin formë do të duhet një bashkëpunim për trajnimin si dhe pajisjen me materiale në fushat e përmbytjeve,



zjarreve, kërkim-shpëtimit.

Nga ana e tij atashen ushtarak i Republikës së Turqisë, kolonel Muhammet Kelami Kablay i shpreh përgëzimet me rastin e marrjes së detyrës së re gjeneralit të brigadës. Me tej, ai shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në çdo aspekt Komandën Mbështetëse, duke sjellë në vëmendje marrëveshjen e ndihmës financiare ushtarake. Gjithashtu u shpreh se është i gatshëm për bashkëpunim të personelit të emergjencave civile në fushën e trajnimit.

Në fund të takimit të dy zyrtarët shkëmbyen dhuratat.

Gjeneral brigade Lisa Hou: Bashkëpunimi midis Forcave të Armatosura Shqiptare dhe të SHBA-ve do të vijojë edhe në të ardhmen

Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it, kryesuar nga gjeneral brigade Lisa Hou, komandante e Gardës së New Jersey-it, zhvilluan një vizitë pune në Bazën Ajrore Farkë, ku u prit nga i deleguari i komandantit të Forcës Ajrore kolonel Gjergji Vasili dhe komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata si edhe pilotë, staf e personel i Forcës Ajrore.

Ekipi i Gardës Kombëtare të New Jersey-it ishte i përbërë nga kolonel Yvonne Mays, drejtor shtabi në Gardën e New Jersey-it, nënkolonel Amy Glatz, menaxhere e çështjeve shtetërore për punësim të barabartë, zonja Jennifer Rodriguez, ndihmëse dhe folëse e menaxheres së shtetit për punësim të barabartë, major Bethanie Schultz, pilote, kapiten Andrew Pope, këshilltar, kapitene Jennifer Wain, oficerë për mbështetjen me zjarr, rreshter Jacqui Robinson, specialist i marrëdhënieve me publikun, ndërsa ekipi i Forcës Ajrore ishte i përbërë nga nënkolonel Silvana Lahi, oficer shtabi për bashkëpunimin civil-ushtarak dhe përfaqësueset vajza dhe gra ushtarake dhe civile të Bazës Ajrore Farkë.

Kolonel Vasili shprehu mirëseardhjen dhe falënderimet në emër të komandantit të Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm



me Gardën Kombëtare të New Jersey-it e SHBA-të, kryesisht në projektet e modernizimit dhe trajnimet e për-

bashkëta të pilotëve të Bazës Ajrore Farkë.

Mbas prezantimit për Bazën

Ajrore Farkë, komandanti i Bazës, nënkolonel Dulemata bëri një përmbledhje më të gjerë për

bashkëpunimin ushtarak duke u fokusuar në planet konkrete të cilat lidhen me trajnimin e pilotëve për të qenë të aftë për të fluturuar me helikopterët "Black Hawk", të cilët së shpejti do të jenë pjesë e kapaciteteve të Forcës Ajrore.

Gjenerale Hou në fjalën e saj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe atyre Shqiptare dhe specifikisht bashkëpunimin ushtarak midis Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe Forcës Ajrore shqiptare, i cili do të vijojë edhe në të ardhmen.

Përfaqësuesi i Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes, kapiten London Nagai informoi gjeneralen Hou mbi planet afatmesme dhe afatgjata midis Forcës Ajrore dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Në përfundim të vizitës, gjenerale Hou pasi u takua me personelin vajza dhe gra të Bazës Ajrore Farkë përfshirë edhe kandidaten për piloten e parë në Shqipëri, nëntogere Armela Murati, realizuan edhe një vizitë në hangarët e helikopterëve dhe në ambientet e Bazës Ajrore Farkë.

Vizitë e komandantit të Forcave Speciale Amerikane për Europën në Forcën Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore, priti në një vizitë zyrtare komandantin e Komandës Amerikane të Forcave Speciale për Europën, gjeneralmajor David H. Tabor.

Gjeneral Kingji e njohu në mënyrë të përmbledhur me punën e bërë të Forcës Tokësore, si dhe shprehu mirënjohjen për zhvillimin e vizitës. Ndër të tjera vlerësoi aktivizimin e Shtabit të Përparuar të Komandës së Forcave Speciale Amerikane për Europën, si një faktor që do të shërbejë për paqen dhe stabilitetin në rajon duke shkruajuar elementët regresive dhe destabilizues.

Në vijim të diskutimit, komandanti i Forcës Tokësore nënvizoi në mënyrë të veçantë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për bashkëpunimin e frytshëm në rrugën e modernizimit, përmirësimit të kapaciteteve njerëzore dhe luftarake të Forcës Tokësore dhe FARSH në përgjithësi, si dhe gjatë angazhimeve të përbashkëta në trajnime dhe misione jashtë vendit.

Nga ana e tij gjeneral Tabor, shprehu kënaqësinë e vizitës në Komandën e Forcës Tokësore dhe vlerësoi bashkëpunimin shumë të mirë që ekziston deri tani mes dy ushtrive, duke i shprehur gjeneral Kingjit mbështetjen e tij të plotë, për



rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit mbështetur në një vizion afatgjatë të zhvillimit të trajnimeve dhe stërvitjeve

të përbashkëta në vend dhe në rajon.

Komandanti i Komandës Amerikane të Forcave Speciale për Europën, gjeneralmajor David Tabor, vijoi më tej axhendën e tij me një vizitë në Komandën e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), ku u informua në lidhje me nivelin e përgatitjes profesionale, kompletimin me pajisje dhe personel, si dhe detyrat operacionale që kryejnë Forcat Speciale, në kuadër të mbështetjes së realizimit të misionit të ROS. Në përmbyllje të vizitës së tij, gjeneral Tabor ndoqi nga afër një demonstrim stërvitor me stacione, të batalionit të Forcave Speciale.



Gjeneral Kingji: Falënderues për mbështetjen e pakursyer nga Garda Kombëtare e New Jersey-it

Në kuadër të aktivitetit "Woman in military" që u zhvillua në vendin tonë, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey gjeneral brigade Lisa Hou dhe stafin e saj shoqëruar. Në bisedën mes dy ushtarakëve të lartë, u vlerësua niveli i lartë i bashkëpunimit që ekziston ndërmjet dy vendeve dhe dy ushtrive tona mike dhe aleate në NATO. Gjeneral Kingji, falënderoi gjeneralen Hou për mbështetjen e pakursyer që efektivët e Forcës Tokësore, kanë gjetur ndër vite nga ana e Gardës së NJ, sidomos në fushën e trajnimit të personelit, si dhe veçanërisht Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit Ushtarak në mbështetjen e dhënë për kompletimin me mjete, pajisje dhe armatim. Nga ana e saj, komandantja e Gardës Kombëtare të NJ, filimisht falënderoi gjeneral Kingjin për mikpritjen e ngrohtë të rezervuar për të dhe stafin e saj. Më tej gjenerale Hou, shprehu mbështetjen e saj dhe të njësisë që ajo drejton, për rritjen dhe thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë. Axhenda e gjenerales Hou, vijoi më tej me një takim të ngrohtë dhe miqësor me personelin ushtarak femër që shërbejnë në Forcën Tokësore dhe u mbyll me një vizitë në ambientet e punës dhe ato stërvitore të efektiveve të batalionit të Dytë të Këmbësorisë(b2k).



INTERVISTA

Intervistë me studentët në Akademinë e Forcave të Armatosura, ushtarakët e rinj: Lorena Demaj, Soni Domi dhe Andrea Dumka

AFA, zgjedhja drejt të ardhmes së sigurt

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Arsimimi ushtarak shqiptar ka kaluar një rrugë plot sakrifica dhe arritja e përsosmërisë në sistemin arsimor është një proces në zhvillim e sipër. Arsimimi është mjeti i suksesit tonë të ardhshëm, arsimimi i mirë i brezave rrit kohezionin shoqëror, garanton ruajtjen dhe përçimin e vlerave kombëtare, si dhe rrit ndërvëprimin rreth vetes dhe botës. Ai i aftëson ushtarakët për të përmbushur qëllimet më të rëndësishme për vendin. Një sistem arsimor cilësor zhvillon ndjenjat e qytetarisë dhe kontribuon në konsolidimin e institucioneve. Në një intervistë për gazetën “Ushtria”, të rinjtë tanë, ushtarakët e ardhshëm sjellin këndvështrimin e tyre mbi të ardhmen e ushtrisë shqiptare.

LORENA DEMAJ

Si u ndjetë kur erdhët fillimisht në ambientet e garnizonit ushtarak?

Dita e parë në garnizon ishte një emocion i madh, pasi unë tashmë kisha arritur të bëhesha pjesë e akademisë ushtarake ku ëndërroja dhe dëshiroja të studioja. Veshja me uniformë ushtarake ishte një ndjesi e veçantë, një ndjenjë krenarie me përshkruante gjithë trupin...

Pse zgjodhët të studioni në një fakultet ushtarak?

Të jem studente në Akademinë e Forcave të Armatosura ka qenë një pasion, një ëndërr e imja. Por përpos këtyre kam parë edhe benefitet që kjo shkollë të ofron.

A është e lehtë të përshtatesh me jetën në një ambient të kufizuar në ‘liritë’ e tij?

Muajt e parë unë e kam pasur mjaft të vështirë. Ka qenë një ndryshim rrënjësor i stilit të



jetesës. E ardhur nga jeta civile nuk ishte e lehtë të qëndroja e izoluar në një ambient të kufizuar në ‘liritë’ e tij, por dëshira dhe pasioni më bëri t’i kapërcej me durim dhe sukses këto rregulla dhe kufizime.

Çfarë ju shtyu të ndiqnit këtë rrugëtim?

Të jem pjesë e Forcave të Armatosura ka qenë një ëndërr e imja që në fëmijëri, e cila me kalimin e viteve ka ardhur duke u përforcuar me integrimin dhe risitë që FA-të po sjellin.

Si është një ditë në shkollën tuaj dhe si është krijimi i marrëdhënieve mes pedagogëve dhe shokëve?

E gjithë dita në shkollën tonë është e programuar nga grupi komandues. Kemi orare të vepërimeve për çdo ditë, ku çdo gjë është e mirë organizuar. Për sa i

përket marrëdhënieve me shokët, mund të them se ndryshe nga universitetet e tjera, ne jemi më të lidhur me njëri-tjetrin, bashkëprojmë dhe punojmë më shumë pasi jemi nga e hëna në të premte së bashku, jemi si një familje. Me pedagogët marrëdhëniet janë tepër të mira, japin shumë nga vetja për formimin tonë ushtarak, shumë prej tyre janë edhe shembuj për ne..

Çfarë prisnit dhe çfarë gjetët në auditorët e fakultetit?

Si një nxënëse që sapo mbarova gjimnazin e përgjithshëm, nga brezat para meje, isha më tepër e informuar lidhur me kushtet dhe rregullat e auditorëve të universiteteve civile. Por të jesh studente në një auditor ushtarak disiplina dhe rregullat ushtarake nuk mungojnë. Disiplina është e pranishme si në pjesën e stërvitjes ashtu edhe në auditor.

“

Për të gjithë të rinjtë shqiptarë që duan të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura unë mund t’iu them se, në qoftë se zgjedhin Akademinë e Forcave të Armatosura për kryerjen e studimeve të larta, do të bëjnë zgjedhjen e duhur nga e cila nuk do të zhgënjehen. Vërtet kjo shkollë ka lodhjet e veta por në fund do të dilni të fituar, si njerëz me një formim të veçantë profesional dhe kulturor. Dhe me një librezë të sigurt punësimi.

Çfarë benefitesh prisni nga këto studime?

Pas mbarimit të këtyre studimeve, sigurimi i një vendi pune është një ndër benefitet që kjo akademi të dhuron. Gjithashtu ofrimi i kurseve dhe trajnimeve si brenda dhe jashtë vendit do të më formojnë dhe zhvillojnë më tepër për t’u bërë një ushtarake e suksesshme me eksperiencë të ndryshme.

Shumë të rinj në mbyllje të ciklit universitar mendojnë të largohen jashtë, po aspiratat tuaja cilat janë?

Unë pasi të mbaroj studimet do të dëshiroja të ndiqja kurse dhe trajnime jashtë vendit, në qoftë se do të më jepej mundësia, por shërbimin tim ushtarak do të doja ta kryeja në Shqipëri, në vendin tim.

Cilat janë përfitimet që ju prisni të merrni në fund të stu-

dimeve?

Pas studimit në Akademinë e Forcave të Armatosura, do të kem përfituar njohuri mjaft të mira në lidership/komandim si edhe në disiplinën personale. Gjithashtu vendosmëria, serioziteti dhe karakteri i fortë janë cilësi që kjo shkollë i ushqen dhe i përvetëson te një student ushtarak.

Si po ndiheni deri këtu?

Deri më tani, çdo gjë e kam kaluar me sukses. Kam pasur edhe vështirësi dhe momente demoralizimi por me punë dhe vullnet çdo gjë mund të arrihet.

Si e shikoni të ardhmen tuaj në strukturat ushtarake?

Si një studente e vitit të parë, dëshiroj që të mbaroj studimet me rezultate të larta dhe të kënaqshme, në mënyrë që ecuria ime në karrierën ushtarake të jetë e gjatë dhe e suksesshme.

Ishte kjo gjëja që ëndëronit?

Patjetër që po, është vërtet privilegj dhe kënaqësi që të studioj në AFA.

Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Deri më tani synimi ose plani im i vetëm është përfundimi me sukses i akademisë, me rezultate të kënaqshme.

Cila është thirrja juaj për të rinjtë shqiptarë që duan të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura?

Për të gjithë të rinjtë shqiptarë që duan të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura unë mund t’iu them se, në qoftë se zgjedhin Akademinë e Forcave të Armatosura për kryerjen e studimeve të larta, do të bëjnë zgjedhjen e duhur nga e cila nuk do të zhgënjehen. Vërtet kjo shkollë ka lodhjet e veta por në fund do të dilni të fituar, si njerëz me një formim të veçantë profesional dhe kulturor. Dhe me një librezë të sigurt punësimi.

SONI DOMI

Si u ndjetë kur erdhët fillimisht në ambientet e garnizonit ushtarak?

Në fillimet e ardhjes time në shkollën ushtarake jam ndjerë shumë i entuziazmuar, dhe që në momentin e parë ndjeva një pjesë timen të kish lindur në këto garnizone.

Pse zgjodhët të studioni në një fakultet ushtarak?

Unë zgjodha të studioja në fakultetin ushtarak, pasi Forcat e Armatosura kanë qenë gjithmonë një ëndërr e imja dhe pasioni për të më ka shtyrë të jem sot pjesë e saj.

A është e lehtë të përshtatesh me jetën në një ambient të kufizuar në ‘liritë’ e tij?

Realisht nuk është e lehtë të përshtatesh në një ambient të kufizuar nga ‘liritë’ që moshatarët tanë në jetën civile i gëzojnë pa ‘limite’, por pasionin tim për Forcat e Armatosura dhe dashurinë time për atdheun, i konsideroj më të rëndësishme se sa liritë që do të kisha në jetën time, përtej mureve të ëndrrës time të bërë tashmë realitet.

Çfarë ju shtyu të ndiqnit këtë rrugëtim?

Arsyeja që më bëri te ndiqja këtë rrugëtim ishte një sfidë me veten time dhe të arrij të bëhem një lider i devotshëm për uniformën dhe të bëj diferencën...

Si është një ditë në shkollën tuaj dhe si është krijimi i marrëdhënieve mes pedagogëve dhe shokëve?

Dita në shkollë fillon me shumë energji pozitive, pedagogët janë shumë të qartë dhe të kuptueshëm, ndërsa në marrëdhënie me shokët jemi familjarizuar shumë dhe ia kalojmë mirë bashkë.

Çfarë prisnit dhe çfarë gjetët në auditorët e fakultetit?

Auditorët ishin përafërsisht siç unë i prisja, por kemi gjetur edhe më mirë se sa prisnim.

Çfarë benefitesh prisni nga këto studime?

Nga studimet që po ndjekim pretendojmë se do të arrijmë një disiplinë vetjake mjaft të dobishme, do të ndihemi mjaft të vlerësuar dhe të suportuar nga shteti ynë.

Jemi në hapat e parë dhe përkrahjen e institucioneve po e shohim çdo dite.

Shumë të rinj në mbyllje të ciklit universitar mendojnë



të largohen jashtë, po aspiratat tuaja cilat janë?

Unë aspiroj t’i shërbej vendit tim, popullit tim, familjes time këtu në atdheun tim, me përkushtim dhe dinjitet.

Cilat janë përfitimet që ju prisni të merrni në fund të

studimeve?

Në fund të studimeve unë pretendoj të marr edukimin, dijen, disiplinën dhe formimin e duhur ushtarak.

Si po ndiheni deri këtu?

Deri në këtë fazë unë ndihem mjaft i kënaqur me çfarë kam

ANDREA DUMKA

Si u ndjetë kur erdhët fillimisht në ambientet e garnizonit ushtarak?

Në të gjitha degët fillimi është i vështirë, veçanërisht kalimi nga qytetar i thjeshtë në qytetar me uniformë, ka vështirësitë e veta, por me kalimin e kohës u përshtata dhe tani ndihem shumë mirë.

Përse zgjodhët të studioni në një fakultet ushtarak?

Ëndrra për t’u bërë ushtarak më ka lindur që në fëmijërinë time dhe Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, ku unë aktualisht studioj është çelësi që do të hapë derën e rrugëtimit tim në karrierën ushtarake.

A është e lehtë të përshtatesh me jetën në një ambient të kufizuar në ‘liritë’ e tij?

Dallimi i ushtarakut nga civili është sakrifica, dhe përdërisa unë dhe studentët e tjerë i kemi hyrë kësaj rruge të vështirë, por të bukur, i kemi marrë parasysh dhe kufizimet që ka jeta ushtarake dhe tani jemi përshtatur më së miri me këto rregulla.

Çfarë ju shtyu të ndiqni këtë rrugëtim?

Unë vij nga familje ushtarakësh dhe e kam pasur gjithmonë dëshirë të jem pjesë e Forcave të Armatosura.

Si është një ditë në shkollën tuaj?

Dita në shkollën tonë fillon me vrapin e mëngjesit në orën 06:00, në orën 08:20 deri në 15:40 kemi orarin e mësimit, më pas kemi kohë të lirë për përgatitje fizike dhe higjienë, në orën 18:30 konsumohet darka pas darkës kemi studim dhe në orën 22:00 mbyllet aktiviteti ditor. Mar-



rëdhëniet me shokët janë shumë të mira, bashkëpunojmë me njëri-tjetrin për të realizuar të gjitha detyrat që na jepen dhe për të arritur qëllimin e përbashkët që kemi.

Çfarë prisnit dhe çfarë gjetët në auditorët e fakultetit?

Të jemi i sinqertë në fakultet gjeta më shumë se ç’ prisja. Fakulteti na ka ofruar një pagë mujore të kënaqshme, ushqim dhe akomodim falas, një mundësi që nuk ta jep asnjë fakultet tjetër.

Çfarë benefitesh prisni nga këto studime?

Pas mbarimit të studimeve kemi të siguruar punësimin në FA dhe mundësi për studime të mëtejshme brenda dhe jashtë shtetit.

Realisht nuk është e lehtë të përshtatesh në një ambient të kufizuar nga ‘liritë’ që moshatarët tanë në jetën civile i gëzojnë pa ‘limite’, por pasionin tim për Forcat e Armatosura dhe dashurinë time për atdheun, i konsideroj më të rëndësishme se sa liritë që do të kisha në jetën time, përtej mureve të ëndrrës time të bërë tashmë realitet.

bërë dhe mësuar, ndihem i vlerësuar dhe i privilegjuar.

Si e shikoni të ardhmen tuaj në strukturat ushtarake?

Unë në të ardhmen shoh një karrierë të gjatë dhe të suksesshme.

Ishte kjo gjëja që ëndërronit?

Po, kjo ka qenë diçka që unë e kam ëndërruar dhe tani po e jetoj në realitet.

Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Synimi im tani për tani është të përfundoj Fakultetin e Forcave të Armatosura me sukses të plotë

Dita në shkollën tonë fillon me vrapin e mëngjesit në orën 06:00, në orën 08:20 deri në 15:40 kemi orarin e mësimit, më pas kemi kohë të lirë për përgatitje fizike dhe higjienë, në orën 18:30 konsumohet darka pas darkës kemi studim dhe në orën 22:00 mbyllet aktiviteti ditor.

Deri tani çdo gjë ka shkuar mirë falë shokëve dhe pedagogëve tanë.

Si e shikoni të ardhmen tuaj në strukturat ushtarake?

Të ardhmen time e shikoj si oficer në strukturat e Policisë Ushtarake.

Ishte kjo gjëja që ëndërronit?

Po gjithmonë kam ëndërruar të jem pjesë e FA-së.

Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Tani për tani kam në plan të mbaroj fakultetin me rezultate sa më të mira.

Cila është thirrja juaj për të rinjtë shqiptarë që duan të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura?

Ju bëj thirrje të gjithë të rinjve, që ju pëlqen Forca e Armatosur, të bashkohen në këtë armatë të madhe se do ia vlejë.

Përfundon Kursi Bazë i Oficerit, në Qendrën Stërvitore Pashaliman

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit me specialitet Detari, me gradën nënlejtënant. Në këtë ceremoni mori pjesë shefi Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj.

Komandanti i Qendrës Stërvitore Pashaliman, kapiten i rangut II Bamir Likaj, personelit të sapo certifikuar iu uroi suksese dhe dijet e marra t'i përdorin në të ardhmen në repartet e tyre.

Faza e kursit u realizua në gërshetim teorik, por kryesisht u përqendruan në veprime praktike, të cilat u zhvilluan në det,

sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare.

Gjithashtu, pjesëmarrësit e këtij kursi u njohën gjerësisht me tema që përfshijnë njohjen e bregdetit shqiptar, sigurinë hidro-lundrimore, luftën kundër ujit dhe zjarrit në anije, shpëtimin e njeriut në det në kushte të ndryshme të motit dhe detit. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi të rëndësishëm. Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë kursantët dhe një foto të përbashkët.



Kundëradmiral Agastra: Bashkëpunimi ynë, kontribut i çmuar në Sigurinë Detare

Kundëradmirali Don Mackinnon, komandant i Strukturës Ndërkombëtare të Sigurisë Detare (IMSC) dhe i Forcës së Organizuar për Detyrë të Koalicionit SENTINEL (CTF), priti komandantin e Forcave Detare Shqiptare, kundëradmiral Adnand Agastrë në Shtabin e IMSC në Manama, Bahrein.

Republika e Shqipërisë ishte shteti i shtatë që iu bashkua IMSC, më 1 nëntor 2019. Vizita i dha mundësinë kundëradmiral Adnand Agastrës dhe delegacionit të tij të shihte drejtpërdrejt se si kjo përpjekje shumëkombëshe punon për të siguruar lirinë e lundrimit në ujërat kyçe të Lindjes së Mesme.

“Kjo është një vizitë e rëndësishme për Shqipërinë, për të përfunduar procedurat dhe detajet e nevojshme për pjesëmarrjen e plotë të vendit tonë në IMSC dhe kjo pjesëmarrje do të jetë një rrugë për të bashkëpunuar dhe dhënë kontributin tonë në Sigurinë Detare”, -tha Agastra. “Megjithatë ne luajmë vetëm një pjesë të vogël në këtë kontribut, ne jemi të lumtur të operojmë në një ambient ndërkombëtar me kaq shumë vende të tjera partnere”.

Gjatë vizitës së tij, Delegacioni Shqiptar u përshëndet në IMSC nga nënadmiralet Brad Cooper, komandant i Komandës Qendrore të Forcave Detare të SHBA (USNAVCENT), komandant i Forcës Detare të Kombinuar dhe i Forcës Shumëkombëshe të Organizuar për Detyrë. Delegacioni vizitoi ambientet e Shtabit të IMSC dhe bazës NSA në Bahrain, mori pjesë në takime me Shtabin e USNAVCENT dhe



● Gjatë vizitës së tij, Delegacioni Shqiptar u përshëndet në IMSC nga nënadmiralet Brad Cooper, komandant i Komandës Qendrore të Forcave Detare të SHBA (USNAVCENT), komandant i Forcës Detare të Kombinuar dhe i Forcës Shumëkombëshe të Organizuar për Detyrë. Delegacioni vizitoi ambientet e Shtabit të IMSC dhe bazës NSA në Bahrain, mori pjesë në takime me Shtabin e USNAVCENT dhe drejtuesit e IMSC dhe përfundoi vizitën e tij me një vizitë në Forcën e Organizuar për Detyrë 59.

drejtuesit e IMSC dhe përfundoi vizitën e tij me një vizitë në Forcën e Organizuar për Detyrë 59.

Kundëradmiral Mackinnon tha: “Unë jam i lumtur të mirëpres sot komandantin e Forcave Detare

Shqiptare, admiral Agastrën, në Shtabin e SENTINEL”. Mackinnon theksoi se sa e rëndësishme është për IMSC mbështetja në bashkëpunimin e këtij koalicioni dhe atë rajonal.

Nënkolonel Mali: Guximi dhe përkushtimi i tyre le të na shërbejë si udhërrëfyes në mbrojtjen e Atdheut

Në memorien e shqiptarëve, viti 1997 do të mbetet si një vit i tmerrshëm dhe i përgjakshëm. Mijëra të rinj humbën jetën pasi e gjithë popullsia ishte e armatosur deri në dhëmbë për shkak të hapjes së depove të armatimit. Shkodra, mbetet një prej qyteteve me bilancet më të rënda nga kjo histori e trishtë, por falë sakrificave të disa oficerëve të policisë apo ushtrisë, situata nuk u përkeqësua edhe më tej, pasi populli mund të pajisej me granata apo raketa.

Po luftohej?! Po kundër kujt?! Sa zemra u copëtuan? Sa nëna vunë rasën e zezë? Sa fëmijë mbetën jetimë? Viti i marrëzisë shqiptare!

Të gjithë shkodranët mbajnë mend mbrëmjen e 12 marsit të vitit 1997, ditën kur qindra qytetarë, u nisën drejt repartit ushtarak dhe baterisë kundër-ajrore që ndodhej në Dobraq, për të marrë armë.

Në tentativë për të qetësuar njerëzit e irrituar, mbetën të vrarë komandanti Muhamet Hasmuja, 38 vjeç, nga komuna Gruemirë, dhe pak minuta më vonë u vra edhe oficeri Arben Hoxha, ndërsa mbeti i plagosur oficeri tjetër, Agron Kodra nga Reçi i Malësisë së Madhe.

“Kur turmat mbërritën tek reparti, ata tentuan të thyejnë barrierat dhe të futen. Ushtarët dhe oficerët ishin në njërin krah me armë në duar, por pa urdhër për të qëlluar dhe në tjetrin krah turmat ku mes tyre kishte edhe të armatosur. Në këtë situatë, Muhameti vendosi të futej në mes të turmës dhe oficerëve të tij për të shmangur përplasjet pasi ushtarët ishin nën presion.

Ai po u bënte thirrje qytetarëve që të largohen dhe situata të qetësohej. Në një moment, ai u rrëzua. Një dorë e zezë, nga turma qëllloi me armë drejt tij. Komandanti nuk u dëgjua më dhe u dha alarmi se Muhameti është qëlluar. Drejt tij, u nisën oficerët Arben Hoxha dhe Agron Kodra për ta ndihmuar, por është dëgjuar një tjetër breshëri zjarri dhe të dy u rrëzuan”.

Por çfarë pasojash do të kishte për Shkodrën dhe Shqipërinë nëse reparti kundër-ajror nuk do të mbrohej deri në fund dhe do të ishte në duart e turmave?

Pasoja fatale! Fatkeqësi të jashtëzakonshme. Kemi të bëjmë me topa kundërajror, raketa në gatishmëri për zjarr dhe tritol. Një pakujdesi sa më e vogël, madje edhe një cigare do të shkaktonte shpërthimin e tyre, pa llogaritur më pas nëse dikush do të aktivizonte topat apo raketat.

25-vjetori i rënies në krye të



detyrës së Dëshmorëve të Atdheut kapiten Muhamet Hasmuja, toger Arben Hoxha, kapter Ismet Ishulli, u përkujtua me nderimet që i takojnë dëshmorëve të atdheut, në ambientet

e batalionit të Parë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b1kFT).

Në ceremoninë e rastit merrnin pjesë: komandanti dhe shtabi i b1kFT-së, familjarë dhe miq të Dëshmorëve

si dhe efektivët e këtij reparti.

Aktiviteti përkujtimor u hap nga komandanti i b1kFT-së nënkolonel Ali Mali, i cili në fillim të fjalës së tij vlerësoi ushtarakët e rënë në krye të detyrës, si shembulli më i mirë i vetëmohimit dhe shpirtit të sakrificës së një ushtaraku, por edhe si burim frymëzimi për brezat që do të vijnë. “Përkushtimi, guximi vetëmohimi, pra vepra e tyre, le të na shërbejë si udhërrëfyes që të edukohemi, trajnohemi e të stërvitemi, për të siguruar e

garantuar mbrojtjen e Atdheut çdo ditë. Dëshmorët gjithmonë bien në emër të lirisë dhe për hatër të lirisë, por të lirisë për të tjerët...” -vijoi më tej fjalën e tij komandanti i batalionit të Parë të Këmbësorisë nënkolonel Mali.

Ceremonia përkujtimore, vijoi më tej me vendosjen e kurorave dhe tufave me lule, pranë lapidarit të Dëshmorëve të Atdheut.

Kapiten Muhamet Hasmuja, toger Arben Hoxha, kapter Ismet Ishulli, ranë në krye të detyrës në Qarkun e Shkodrës në vitin 1997.



Nga data 14 deri më 29 mars, BE-ja do të marrë pjesë në takimet e rifilluara të biodiversitetit global për të avancuar në zhvillimin e Kornizës Globale të Biodiversitetit pas vitit 2020 - një marrëveshje e re globale për të ndaluar dhe rikthyer humbjen e bimëve, kafshëve dhe ekosistemeve të planetit. Bisedimet në Gjenevë janë sesioni i fundit zyrtar për qeveritë për të negociuar mbi marrëveshjen globale një herë në një dekadë përpara se të mbërrijë në Kunming, Kinë, që do të miratohet në Konferencën e OKB-së për Biodiversitetin COP15 më vonë gjatë këtij viti. Korniza do të drejtojë veprimin global për natyrën dhe njerëzit, gjë që është jetike për trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe ndërtimin e një bote më të drejtë, më të sigurt dhe më të shëndetshme për të gjithë, kudo.

Komisioneri për Mjedisin, Oqeanet dhe Peshkimin Virginijus Sinkevičius tha: “Në këto kohë sfida, multilateralizmi është më kritik se kurrë, për njerëzit dhe natyrën nga e cila ne varem. Provat janë të qarta: ne kemi nevojë për një të ardhme në harmoni me natyrën, për veten tonë, për brezat e ardhshëm, për klimën tonë dhe për zhvillimin e qëndrueshëm, dhe ne kemi nevojë për një udhërrëfyes të përbashkët për ta arritur atë. Në COP15, komuniteti ndërkombëtar do të kërkojë të bjerë dakord për një kuadër ambicioz global të biodiversitetit me monitorim të fortë për të matur progresin në terren në kthimin e humbjeve të natyrës. Por ne nuk jemi ende atje dhe duhet të ngushtojmë ndjeshëm hendeqet ndërmjet qëndrimeve të palëve. BE shkon në negociatat e Gjenevës duke nxitur për ambicie dhe duke udhëhequr me shembull.”

BE-ja ka treguar leadership, duke punuar me vendet me të njëjtin mendim drejt një marrëveshjeje ambicioze, me objektiva të matshme për të adresuar nxitësit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të humbjes, dispozita shumë më të forta për monitorimin dhe rishikimin dhe qartësi mbi mjetet e zbatimit.

BE-ja do të negociojë për elementët e mëposhtëm të Kornizës si minimum:

- Qëllime, piketa dhe objektiva ambicioze, të matshme dhe të kufizuara në kohë, që do të synojnë që të gjitha ekosistemet e botës të restaurohen, të jenë elastike dhe të mbrohen në mënyrë adekuate deri në vitin 2050;

- Synime, për të adresuar nxitësit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të humbjes së biodiversitetit dhe për të siguruar përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke përfshirë objektivin 30x30 për të mbrojtur të paktën 30% të tokës dhe oqeanëve në botë deri në vitin 2030, të plotësuar me objektiva që adresojnë nxitësit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të humbjes së biodiversitetit;

- Dispozita operative, për mobilizimin e financave dhe mjeteve të tjera të zbatimit; në këtë kontekst, në shtator, presidentja von der Leyen njoftoi se BE do të dyfishojë financimin e saj ndërkombëtar të biodiversitetit, veçanërisht për vendet më të cenueshme;

- Procese shumë më të forta të zbatimit, monitorimit dhe rishikimit, duke përfshirë transparencën për zbatimin e synuar, raportimin, një analizë globale të boshllëqeve dhe



mbajtjen e stokut me rritjen e përpjekjeve nëse është e nevojshme;

- Zbatimi efektiv i objektivit të Konventës së 3-të të Biodiversitetit në lidhje me aksesin dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve nga përdorimi i burimeve gjenetike të lidhura me biodiversitetin, i cili në të njëjtën kohë garanton që shkenca, kërkimi dhe inovacioni mund të vazhdojnë të sjellin përfitime të plota që gjithashtu mbështesin zbatimin e objektivave të tjerë;

- Sigurimi i respektimit të të drejtave të popujve indigjenë dhe pjesëmarrjes së plotë dhe efektive nga popujt dhe palët e interesuara indigjene.

BE-ja do të bazohet në rezultatet e mira të Asamblesë së Mjedisit të OKB-së të javës së kaluar në Nairobi, duke përfshirë përkufizimin e dakorduar të zgjidhjeve të bazuara në natyrë, të cilat janë thelbësore për natyrën, njerëzit dhe klimën.

Raporti Global i Vlerësimit i IPBES, mbi Biodiversitetin dhe kontributi i publikuar së fundmi në Raportin e 6-të të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike thekson se bota ka një dritare të shkurtër, që mbyllet me shpejtësi për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme. Ai bën thirrje për veprime urgjente për restaurimin e ekosistemeve të degraduara, brenda dekadës së ardhshme për të zbutur

ndikimet e ndryshimeve klimatike, veçanërisht duke rivendosur ligatinat dhe lumenjtë, pyjet dhe ekosistemet bujqësore të degraduara.

Konferenca e OKB-së për Biodiversitetin (COP15) po zhvillohet në dy pjesë. Pjesa e parë u zhvillua në Kunming dhe praktikisht nga 11 deri më 15 tetor 2021 me një segment të nivelit të lartë. Palët në Konventën për Diversitetin Biologjik riafirmuan angazhimin e tyre për arritjen e Vizionit 2050 të “Të jetosh në harmoni me natyrën, duke miratuar Deklaratën e Kunming-ut”. Kjo politikë tani duhet të përkthehet në mbështetje konkrete politike për një kuadër ambicioz të biodiversitetit global pas vitit 2020 dhe zbatimin e plotë të tij pasues.

Pjesa e dytë e COP15 do të zhvillohet në Kunming, Kinë më vonë në vitin 2022. Në këtë kohë, Palët do të takohen për të përfunduar negociatat dhe për të vendosur mbi një Kornizë të re Globale të Biodiversitetit pas 2020.

Sipas Marrëveshjes së Gjellbër Europiane, Komisioni European miratoi Strategjinë e tij të BE-së për Biodiversitetin vitin e kaluar, e cila synon të vendosë biodiversitetin e Europës në rrugën drejt rimëkëmbjes deri në vitin 2030. Si pjesë e strategjisë, Komisioni do të paraqesë një ligj pionier për restaurimin e natyrës më vonë këtë muaj.



Negociatat globale të biodiversitetit COP15, BE udhëheq ambicien për një marrëveshje të re për të mbrojtur njerëzit dhe planetin

Shtetet anëtare miratojnë një qasje të përgjithshme për një direktivë të BE-së që synon të forcojë barazinë gjinore në bordet e korporatave

Rritja e përqindjes së grave në pozicione vendimmarrëse ekonomike pritet të ketë efekte pozitive në mbarë ekonominë

Ministrat e Punës dhe Çështjeve Sociale ranë dakord sot për një “qasje të përgjithshme” mbi legjislacionin e propozuar të BE-së që synon të përmirësojë ekuilibrin gjinor midis drejtorëve jo ekzekutivë të kompanive të listuara.

Élisabeth Borne, Ministre Franceze për Punën, Punësimin dhe Përfshirjen Ekonomike: “Marrëveshja e sotme në Këshill është një hap i rëndësishëm përpara. Unë bëj thirrje për një fillim të shpejtë të negociatave me Parlamentin European, me synimin për miratimin përfundimtar të kësaj direktive, e cila do të ndihmojë në adresimin e tavanit të qelqtë me të cilin gratë përbalen ende shumë shpesh në botën e punës.”

Direktiva synon të vendosë një objektiv sasior për përqindjen e anëtarëve të seksit të nën-përfaqësuar në bordet e kompanive të listuara. Kështu, kompanitë do të duhet të ndërmarrin hapa për të arritur, deri në vitin 2027, objektivin minimal për të pasur 40% të pozicioneve të drejtuesve jo ekzekutivë nga anëtarët e seksit të nën-përfaqësuar, ose 33% nëse përfshihen të gjithë anëtarët e bordit. Kompanitë që nuk do të mund t'i arrijnë këto objektiva do të duhet të zbatojnë kritere të qarta dhe të formuluar neutralisht kur emërojnë ose zgjedhin drejtuesit.

Shtetet anëtare do të duhet gjithashtu të sigurojnë që kompanitë t'u japin përparësi kandidatëve të seksit të nën-përfaqësuar kur zgjedhin midis kandidatëve të cilët janë njëlloj të kualifikuar për sa i përket përshtatshmërisë, kompetencës dhe performancës profesionale.

Rregullime të mundshme në nivel kombëtar

Vendet që kanë vendosur masa të tilla si objektiva kombëtare për të arritur një përfaqësim më të ekuilibruar të grave dhe burrave mund të pezullojnë kërkesat e direktivës në lidhje me emërimin ose zgjedhjen e anëtarëve të bordit. E njëjta gjë vlen edhe për vendet që kanë bërë tashmë progres drejt objektivave të përcaktuara në direktivë. Këshilli gjithashtu sqaron se u takon shteteve anëtare (dhe jo kompanive) të zgjedhin midis dy objektivave të propozuar, përkatësisht 40% për drejtorët jo ekzekutivë ose 33% për të gjithë anëtarët e bordit.

Është bërë përparim, por ekuilibri mbetet

Megjithatë është bërë përparim drejt rritjes së barazisë gjinore në bordet e korporatave, ky progres mbetet i pabarabartë. Në tetor 2021, vetëm 30.6% e anëtarëve të bordit dhe vetëm 8.5% e kryesuesve të bordit ishin gra. Hendeuku midis shteteve anëtare është i gjerë. Ato ku masat janë vendosur po bëjnë përparim shumë më të shpejtë se ato në të cilat nuk kanë bërë.

Efektet pozitive në tregun e punës

Rritja e përqindjes së grave në pozicione vendimmarrëse ekonomike pritet të ketë efekte pozitive në mbarë ekonominë. Për më tepër, rreth 60% e të sapo-diplomuarve universitarë në BE janë gra. Përmirësimi i ekuilibrit gjinor në bordet e kompanive do t'i mundësonte gjithashtu numrit të madh të grave me kualifikim të lartë në Europë të realizojnë potencialin e tyre të plotë.



"E ardhmja e Europës": Një tjetër Konferencë, kushtuar propozimeve të qytetarëve

40 rekomandime janë përgatitur nga Paneli i Qytetarëve Europianë për temat: "BE në botë/migrimi", në Maastricht, Holandë, dhe 48 rekomandime nga Paneli për temat: "Një ekonomi më e fortë, drejtësi sociale dhe vende pune, arsimit, kultura, rinia dhe sporti/transformimi dixhital", në Dublin, Irlandë. Këto ide, si dhe ato që burojnë nga Panelet Kombëtare të Qytetarëve, organizuar nga Shtetet Anëtare, u prezantuan dhe u diskutuan në Strasburg, në konferencën "E Ardhmja e Europës". Ndërsa Paneli i Qytetarëve Europianë në Dublin pa qytetarët që merrnin iniciativën për të qëndruar së bashku në një shfaqje solidariteti me Ukrainën. Situata në Ukrainë ishte një edhe sfond i diskutimeve të këtyre seancave plenare, edhe me pjesëmarrjen e qytetarëve ukrainas.

